



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BULQIZË
SEKTORI I AUDITIT BRENDSHEM

Nr. 6745/1 Prot

Bulqizë, më 15.10. 2025

Drejtuar: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Për : Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Tiranë

Subjekti: Mbi dërgimin e *“Planit Strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për periudhën 2026-2028.*

Në zbatim të pikës c, të nenit 14 të ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar , dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm , njësia e auditimit të brendshëm ka hartuar “Planin Strategjik dhe vjetorë të ,veprimtarisë së auditimit të brendshëm për periudhën 2026 -2028”. *Bashkëlidhur ju dërgojmë relacionin për planin strategjik e vjetor si dhe formatet përkatëse.*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARI

FESTIME MJESHTRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BULQIZË
SEKTORI I AUDITIT BRENDSHEM

Nr. 6745 Prot.

Bulqizë, më 15/10/2025

MIRATOHET

FESTIME MJESHTRI

KRYETAR

**Plani Strategjik dhe Vjetor
për**

**Veprimtarinë e Sektorit të Auditimit të Brendshëm
në Bashkinë Bulqizë
Viti 2026-2028**

• **Hyrje**

Bashkia Bulqizë e ushtron veprimtarinë e saj në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, legjislacionin përkatës sipas çdo fushe veprimtarie të saj, si dhe në mbështetje të Rregullores së Brendshme të Bashkisë.

Bashkia Bulqizë ka si qëllim ofrimin e shërbimeve publike banorëve të saj nga një staf i kualifikuar, nëpërmjet të ardhurave që do t'i mbledhë nga taksapaguesit, nga transfertat e pakushtëzuara dhe të kushtëzuara, si dhe nga fonde të tjera të siguruara nga sponsorë.

1- Qëllimi Planit Strategjik dhe misioni i NJAB

1-1-Qëllimi i Planit Strategjik

Plani Strategjik 2026-2028 "Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Bulqizë", ka si qëllim identifikimin e fushave të veprimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në këtë institucion, për periudhën përkatëse dhe duke u bazuar në analizën e risqeve të këtyre programeve dhe veprimtarive, përcakton mbulimin dhe frekuencën e auditimit. Plani strategjik është përgatitur mbi bazë risku, pra puna e auditit është fokusuar në ato sisteme apo fusha ku gjërat ka të ngjarë të mos bëhen siç

duhet ose siç janë planifikuar. Plani strategjik i përgatitur përfshin periudhën (1 +2) vitet 2026-2028 dhe mbulon të gjitha fushat me risk .

1.2-Misioni i NJAB

Auditimi i brendshëm në ushtrimin e veprimtarisë së tij të pavarur dhe objektive synon të ndihmojë Titullarin e Bashkisë Bulqizë të arrijë objektivat për këtë institucion, duke dhënë rekomandime të vlefshme për përmirësimin e çdo sistemi. Në veprimtarinë e tij auditimi i brendshëm do të bëjë vlerësime dhe do të japë opinione dhe rekomandime objektive, për mjaftueshmërinë dhe funksionimin e sistemeve, për përputhjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore dhe funksionimin e elementëve të kontrollit të brendshëm (ambjenti i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi, komunikimi dhe monitorimi). Veprimtaria e auditimit të brendshëm siguron titullarin e Bashkisë se fondet publike janë përdorur me ekonomi, efikasitet dhe eficiencë dhe sipas planit dhe qëllimit të miratuar me Vendimin e KB për buxhetin.

2-Organizimi i NJAB dhe Kuadri Ligjor

Struktura e NJAB

Për vitin 2025, NJAB e Bashkisë Bulqizë është miratuar në strukturën organizative me 3 auditues të brendshëm, një përgjegjës dhe dy audites .

Kuadri Ligjor .

NJAB e Bashkisë Bulqizë e ushtron aktivitetin e saj duke u bazuar kryesisht në Ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, Manualin e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik të ndryshuar, në Ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar ,LigjinNr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” si dhe sipas subjektit që auditohet në ligjet përkatëse.

3-Objektivi strategjik i funksionit të auditimit të brendshëm është:

a) Të nxisë politikat e qeverisjes së mirë, përmirësimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në terma të eficiencës, ekonomisë dhe efektivitetit në të gjithë subjektet që do të auditohen. Në mënyrë më specifike ky objektivi në kuadrin e gjithë sistemit detajohet si:

- Dhënia e sigurisë objektive, që sistemet e kontrollit janë vendosur, funksionojnë me efektivitet në një shkallë të përshtatshme mjaftueshmërie brenda subjekteve të audituara;
- Dhënia e sigurisë së pavarur dhe objektive si dhe këshillimeve të cilat shtojnë vlerën, përmirësojnë operacionet dhe ndihmojnë subjektet e audituara të arrijnë objektivat;

1- Minimizimi i mundësisë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim objektiva këto, që do të arrihen nëpërmjet:

2- Menaxhim efektiv i burimeve të auditimit, bazuar në aftësitë profesionale

- 3- Bashkëpunim cilësor dhe profesional me organizatat e audituara për hartimin dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit.
- 4- Çertifikimin dhe rritjen e vazhdueshme të kualifikimit të auditëve përmes trajnimeve në fushën e procedurave dhe metodave/teknikave të auditimit si dhe teknikave mbi vlerësimin e riskut.
 - planifikimit dhe kryerjes së auditimeve të kombinuara të sistemeve të pajtueshmërisë dhe financiare;
 - kryerjes së Auditimeve sipas kërkesës së titullarit apo njoftimeve,

Përmbajtja e Planit Strategjik

Ky plan përmban çështjet si më poshtë:

Objektivat strategjike të Sektorit të Auditimit të Brendshëm..

- Identifikimin e të gjitha subjekteve të vartësisë, kohën e auditimit të fundit dhe klasifikimin e tyre.
- Identifikimi dhe klasifikimi i subjekteve që konsiderohen potenciale, për nga tregues të tillë si rëndësia, buxheti, burimet njerëzore, kompleksiteti i operacioneve, shtrirja etj.
- Klasifikimi i subjekteve mbi bazën e riskut, duke ju nënshtruar një analize risku.
- Identifikimin e nevojave dhe kërkesave për auditime.
- Llogaritja e burimeve të auditimit në dispozicion duke balancuar këto burime me nevojat për auditim sipas klasifikimit të mësipërm.
- Identifikimi i subjekteve të vartësisë, kohës së auditimit të fundit dhe klasifikimin e tyre.

Spektori i Auditimit të Brendshëm mbulon me auditim grup subjektet si më poshtë:

- Drejtori 9 , Sektor dhe inspektoriate 6, Njësi Administrative 7 , subjekte private 1 : Sport Klub Bulqiza sh.p.k dhe 1 Agjensi të Shërbimeve Publiuke. ,gjithsej 24 subjekte dhe Auditime sipas kërkesës së titullarit .
- Identifikimi i subjekteve në të cilat kanë ndodhur ndryshime organizative, operacionale ose ligjore të rëndësishme, krahasuar me periudhat e mëparshme.
 - Ndryshimet më të fundit strukturore të pa konsideruara në planin e mëparshëm strategjik dhe që diktojnë rishikimin e tij janë:
 - Përmirësime strukturore brenda Drejtorive dhe sektoreve ekzistuese jo vetem si formë por dhe në përmbajtje.

4-Identifikimi dhe klasifikimi i subjekteve sipas rëndësisë.

Plani Vjetor dhe ai Strategjik përmban tre grupe subjektësh të zgjedhura për auditim të cilat janë:

a - Subjekte të cilat klasifikohen potenciale nga pikëpamja e madhësisë së buxhetit :Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit ,Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, Drejtoria të Menaxhimit të Burimeve Njerzore , Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Planifikimit , Kontrollit të Territorit , Mjedisit dhe Pronave.

b-Subjekte të cilat konsiderohen potenciale nga pikëpamja e rëndësisë: Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, Agjensia e Funksioneve të Transferuesme (Agjensia e Shërbimeve Publike).

c)Subjekte të cilat konsiderohen potenciale për nga burimet njerëzore ,Drejtori ,Njësi Administrative , e sektore inspektorate etj .

5- Identifikim dhe vlersimi i risqeve.

Gjatë hartimit të planit strategjik 2026-2028 ,janë planifikuar për tu audituar subjekte me risk të lartë e të mesëm e të ulët.Në planifikimin e nivelit të risqeve jemi bazuar në kompleksitetin e subjektit objekt auditimi ,fushat e veprimtarisë ,buxhetin ,burimet njerëzore ,periudhën e paaudituar,gjetjet e mëparëshme të auditimit etj.

Duke ju nënshtruar një analize risku si në pasqyrën nr. 1 bashkëlidhur, është bërë kategorizimi i zonave me risk në tre nivele, i lartë, i mesëm dhe i ulët.

Analiza dhe renditja sipas riskut, është bazuar mbi:

-Rregjistrat e risqeve të evidentuara nga strukturat e bashkise si gjurmë auditi.

-Eksperienca nga auditimet e mëparshme.

-Ndryshimet më të fundit të pësuara në bazën ligjore/rregullative të sistemit financiar publik/njësive/institucioneve vartëse.

-Janë kategorizuar si zona me risk te lartë :Sistemi i Prokurimeve, Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit ,Sistemi i kontabilitetit , Sistemi i te Ardhurave dhe Sistemi Urbanistikës.

-Vlerësimi i Risqeve të Auditimit

Në vijim jepen faktorët e riskut të cilët mendohet se do të shoqërojnë procesin e auditimit në përmbushjen e planit vjetor të auditimit 2025. Vlerësimi i tyre sipas rëndësisë së riskut janë paraqitur në pasqyrën në vijim.

Grupet më kryesore të risqeve të auditimit janë:

- Risqe që shkaktohen nga burimet njerëzore të auditimit.
- Risqe që shkaktohen nga krijimi i kushteve të punës.
- Risqe që vijnë nga moszbatimi i Standarteve e Manualit të Auditimit, Kodit të Etikës së Auditimit, etj.
- Risqe që vijnë nga marrëdhënie me palët e audituara.

Tabela e Vlersimit të Riskut

Nr	Fusha me risk	I ulët	I mesem	I lartë	Menaxhimi i risqeve
	<i>Risqe që shkaktohen nga burimet njerëzore të auditimit</i>				
a	a			X	Ndarja e detyrave sipas nivelit profesional
				X	Kërkesë NJQH/AB për trajnime
	<i>Risqe që shkaktohen nga krijimi i kushteve të punës</i>		X		
b	1- Pajisja me ambiente zyra etj	X			Akomodimi me zyra në subjektet që auditohen dhe kompjutera është i nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë
	2- pajisja me mjete pune, kompjutera etj		X		
	<i>Risqe që vijnë nga moszbatimi i Manualit të Auditimit, Kodit të Etikës së Auditimit etj.</i>				
c	1-Risku nga moskuptimi i procedurave të Manualit		X		Do të monitorohet sistematikisht nga Drejtuesi i NJAB
	2- Risku nga mosrespektimi Kodit të Etikës së Audituesit	X			
	<i>Risqe që vijnë nga marrëdhënie me palët e audituara</i>	X			
d	1-Mangësitë në krijimin e kushteve, ambienteve të punës etj.	X			Do të bëhen përpjekje për të eliminuar efektin e riskut
	2-Risqe për vonesat në				

vënien në dispozicion të				
auditit të dokumentacionit				
dhe stafit të subjektit	X			
3-Risqe që vijnë nga	X			Përgjithësisht procedurat e
metodat manuale të punës,				punës janë automatizuar
informatizimi i dobët i				me përjashtime të vogla.
proceseve etj.				

Kufizimi i auditimit :

Risqet e mundshme të auditimit që mund të pengojnë arritjen e objektivave parashikohen :

- Mosplotësimi i strukturës për mbulimin e subjekteve të planifikuara për auditim.
- Aftësitë profesionale , kualifikimi dhe provoja e punës së auditueseve që do të rekrutohen .

Implementimi me mangësi i mekanizmave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në institucion .

Prioritetet për 3 vitet (1 vit i planifikuar + 2 vitet e tjera)

Të implementojmë Standartet Ndërkombëtare të Auditimit në çdo mision auditimi në mënyrën me të mirë të mundshme duke rritur nivelin profesional të auditueseve në mënyrë që NJAB të konsiderohet vlerë e shtuar e Bashkisë Bulqizë.

6.- Gjykimi i Sektorit të Auditit mbi evidencat dhe eksperiencat e mëparshme.

Duke u nisur nga të gjithë indikatorët e mësipërm, Sektori i Auditimit vlerësoi nevojat për auditim për periudhën 3 vjeçare, duke rakorduar burimet në dispozicion për auditim, si dhe indikatorët e mësipërm sipas rëndësisë. Është bërë një koordinim i të gjitha vlerësimeve të kryera më sipër, duke konsideruar, objektivat e auditimit, subjektet me mbi dy vjet pa u audituar, fushat në të cilat kanë ndodhur ndryshime në rregulla e operacione, subjektet potenciale, klasifikim mbi bazë risku, nevojat e menaxhimit për auditime specifike etj., të cilat më në detaje janë dhënë në pikat e këtij plani.

7- Plani Vjetor 2026

Planifikimi i subjekteve për auditim është procesi më i rëndësishëm për disiplinimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Ky plan siguron që elementet e riskut janë adresuar si duhet duke planifikuar si prioritare për auditim, misione mbi bazën e vlerësimit të riskut, çka do të garantonte besueshëm arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë Bulqizë.

Planifikimi është kryer duke argumentuar të gjitha çështjet që lidhen me veprimtarinë vjetore të auditimit, si dhe arsyetimin mbi të cilin është bazuar zgjedhja si risku, frekuenca midis dy auditimeve, shqetësimet e menaxhimit, prioritetet e institucionit, si dhe rezultatet e eksperiencave të auditimit bazuar në auditimet e mëparshme.

I. Prioritetet e auditimit për vitin 2026.

Për vitin 2026 Sektori i Auditimit të Brendshëm Bashkisë Bulqizë kërkon të arrijë objektivat e mëposhtme të cilat janë:

-Shtimi i vlerës përmes:

-Mbrojtjes së vlerës së subjekteve duke përsosur mjedisin e kontrollit të brendshëm

-Përmirësimin e menaxhimit efektiv të shpenzimeve të fondeve publike.

-Garantimi i zhvillimit të veprimtarisë në përputhje me praktikën më të mirë profesionale.

-Menaxhimi efektiv i burimeve të auditimit, bazuar në aftësitë profesionale si dhe përmes koordinimit me auditimin e jashtëm.

-Bashkëpunimi cilësor e profesional me subjektet e audituara për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

- Rritjen e kualifikimit të audituesve përmes trajnimeve në fushën e procedurave/ metodave/ teknikave të auditimit, si dhe teknikave mbi vlerësimin e riskut.

II-Argumentim mbi çështjet që lidhen me planifikim vjetor të veprimtarisë audituese. Arsyetimi i përdorur në zgjedhjen e subjekteve për planifikim.

Procesi i planifikimit vjetor të veprimtarisë audituese të Sektorit të Auditimit të Brendshëm është bazuar në Standartet Globale të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin nr.103, datë 23.07.2025 të Ministrisë së Financave, Manualin e AB dhe Udhëzimin e DHAB në Ministrinë e Financave.

Në listën e subjekteve të zgjedhura për auditim janë përfshirë kryesisht subjekte që janë vlerësuar me risk të lartë dhe subjekte që kanë më shumë se dy vjet të pa audituar si: *Drejtoria të Menaxhimit të Burimeve Njerzore, Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronave, Agjensia e Funksioneve të Transferuesme (Agjensia e Shërbimeve Publike), "Sport Klub Bulqiza" SHPK, Drejtoria e Kujdesit Social dhe Njësia Administrative Ostren.*

Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2026

- 1. Zbatimi i Rekomandimeve për vitin 2025*
- 2. Drejtoria të Menaxhimit të Burimeve Njerzore, Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse*
- 3. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit*
- 4. Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronave,*
- 5. Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare,*
- 6. Agjensia e Funksioneve të Transferuesme (Agjensia e Shërbimeve Publike).*
- 7. "Sport Klub Bulqiza" SHPK*
- 8. Drejtoria e Kujdesit Social*
- 9. Njësia Administrative Ostren*

8-Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë.

Për kryerjen e një auditimi ndiqet kjo procedurë;

1. Subjektet që do të auditohen do të njoftohen paraprakisht për auditimin që do të kryhet, duke përcaktuar periudhën që do të kryhet auditimi .
2. Për çdo auditim do të përpilohet urdhër-shërbimi në të cilin përcaktohet grupi i punës që do të kryejë auditimin.
3. Grupi audituesve do të përpilojë programin e punës në të cilën janë përfshirë tematikat dhe referencat ligjore .
4. Përpara fillimit të auditimit merret kontakt me drejtuesit e subjektit që auditohet , ku nga grupi auditimit duhet të jepen sqarime mbi procedurën që do të ndiqet për kryerjen e auditimit si dhe përcaktohet vendi qendrimit për grupin e auditimit .(Takimi i Hapur)
5. Në perfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit ,grupi i auditimit përpilon Projekt-Raportin e Auditimit ,ku brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së këtij Projekt-Raporti caktohet takimi pajtues ku diskutohen problematikat e konstatuar.
6. Hartohet Raporti-Final dhe nëse ka observime nga grupi i auditimit bëhet verifikimi i observimit.
7. Me nënshkrimin e Raportit-Final nga grupi auditimit hartohet Memorandumi ku infôrmohet Kryetari i Bashkise për subjektin e audituar.
8. Pergatitet shkresa për mbylljen e angazhimit të auditimit e cila sipas nënshkrimit nga drejtuesi i njesisë së auditimit dhe titullari ,dërgohet në subjektin e audituar.

Bashkëlidhur:

Pasqyra nr.1: Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2026

Pasqyra nr.2: Plani strategjikë i subjekteve të synuara për të audituar për vitet 2026,2027,2028.

Pasqyra nr.3: Plani angazhimeve të NJAB për vitin 2026

Pasqyra nr.4:Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim te NJAB për v.2026

Pasqyra nr.5:Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2026.

P/ Sektorit të Auditimit të Brendshëm

Belina Toska



Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2026

Nr	Subjekte për tu audituar	Fusha për tu audituar	VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT				
			I lartë	I mesëm	I ulët	I lartë	I ulët
a.	1	2	3	4	5		
1	Bashkia Bulqizë						
1.1	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerzore ,Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse	Kontrolli i procesit të rekrutimit ,regjistri i personelit, rregulloret ,etj dhe sistemi i prokurimeve ,formulimi i kontratave .	I lartë				
1.2	Drejtoria e Administrimit të Cështjeve Ekonomike dhe Financiare	Kontrolli i buxhetit,kontabiliteti,magazina, si dhe sistemi i detyrimeve të prapambetura dhe kontrolli i detyrimeve të prapambetura .	I lartë				
1.3	Drejtoria e Planifikimit , Kontrollit të Territorit , Mjedisit dhe Pronave	Ndjekja e zbatimit të kontratave të investimeve,procedurat për dhenien e lejeve të ndërtimit etj.	I lartë				
1.4	Drejtoria e Zhvillimit Rural	Këshillim shërbim bujqësor dhe blektoral.				I ulët	
1.5	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Kontrolli i procedurave të ndjekura për vjeljen e të ardhurave ,politikat fiskale ,zhvillimit ekonomik dhe turizmit etj.	I lartë				
1.6	Drejtoria e Kujdesit Social	Menaxhimi i procesit ,plotësia e dosjeve .		I mesëm			
1.7	Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave	Menaxhimi i shërbimeve dhe inspektimi në terren .		I mesëm			
1.8	Drejtoria e Shërbimeve Sociale ,Arsimit , Trashëgimisë kulturore ,Rinisë dhe Sporteve	Organizimi i aktiviteteve ,sportive e rinore , planifikimi i aktiviteteve ,performanca në realizimin e tyre ,etj.		I mesëm			
2.1	Gjendja Civile	Menaxhimi i shërbimeve				I ulët	
2.2	Drejtoria e Funksioneve të Patransferueshme	Procedurat ,planet,masat per gjoba ,rekrutim i inspektoreve, rekrutimi i rrisqeve .Planet e Inspektiveve, vendosje objektivash , zvogelimi i rriskut nga fatkeqesite dhe mbrojtjen civile ,planet e inspektiveve ,vendosje objektivash, Planet e masave e marra ,zbatimi i tyre, rekrutimi i rrisqeve etj.		I mesëm			

2.3	<i>Sektor i Integritit European dhe Ndhimës së huaj</i>	Vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera nga BE.		I mesëm	
2.4	<i>Njësia Administrative Fushë Bulqizë</i>	Menaxhimi shërbimeve dhe inspektimi në terren .		I ulët	
2.5	<i>Njësia Administrative Zerqan</i>	Menaxhimi shërbimeve dhe inspektimi në terren .		I ulët	
2.6	<i>Njësia Administrative Shupenzë</i>	Menaxhimi shërbimeve dhe inspektimi në terren .		I ulët	
2.7	<i>Njësia Administrative Ostren</i>	Menaxhimi shërbimeve dhe inspektimi në terren .		I ulët	
2.8	<i>Njësia Administrative Trebisht</i>	Menaxhimi shërbimeve dhe inspektimi në terren .		I ulët	
2.9	<i>Njësia Administrative Martanesh</i>	Menaxhimi shërbimeve dhe inspektimi në terren .		I ulët	
3	<i>Njësia Administrative Gjoricë</i>	Menaxhimi shërbimeve dhe inspektimi në terren .		I ulët	
3.1	<i>Këshilli i Bashkisë Bulqizë</i>	Vendimet dhe ligjshmeria .		I ulët	
2	Agjensia e Funksioneve të Transferueshme(Agjensia e Shërbimeve Publike)	Menaxhimi i shërbimeve dhe inspektimi në terren , mirmbajtja e rrugëve ,mjeteve te transportit,menaxhimit te institucioneve arsimore dhe punëve publike,dekorit dhe mirmbajtjes se qytetit ,etj .			I lartë
3	Sport Klub Bulqiza SHPK	Sistemi i kontabilitetit,sistemi i pagave , shërblimeve dhe shërbimeve,sistemi i planifimit e realizimit të të ardhurave nga aktivitetet sportive etj.			I lartë

Drejtuesi i NJAB Belina Toska

SUBJEKTE TË SYNUARA PËR TU AUDITUAR SIPAS VITEVE						
Nr	Viti planifikuar 2026	Niveli i Riskut (V. planifikuar)	Viti I planif+1 2027	Niveli i Riskut (V. planif.+1)	Viti I planif+2 2028	Niveli i Riskut (V. planif.+2)
a.	1	2	3	4	6	
1	Kontroll i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2026 .	I mesëm	Kontroll i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2027 .	I mesëm	Kontroll i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2028 .	I mesëm
2	<u>Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore ,Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse</u> : Kontrolli i proceseve të rekrutimit , regjistri i personelit, rregulloret ,etj dhe sistemi i prokurimeve ,formulimi i kontratave .	I lartë	<u>Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore ,Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse</u> : Kontrolli i proceseve të rekrutimit , regjistri i personelit, rregulloret ,etj dhe sistemi i prokurimeve ,formulimi i kontratave .	I lartë	<u>Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore ,Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse</u> : Kontrolli i proceseve të rekrutimit , regjistri i personelit, rregulloret ,etj dhe sistemi i prokurimeve ,formulimi i kontratave .	I lartë
3	<u>Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit</u> :Kontrolli i procedurave të ndjekura për vjeljen e të ardhurave ,politikat fiskale ,zhvillimit ekonomik dhe turizmit etj.	I lartë	<u>Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit</u> :Kontrolli i procedurave të ndjekura për vjeljen e të ardhurave ,politikat fiskale ,zhvillimit ekonomik dhe turizmit etj.	I lartë	<u>Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit</u> :Kontrolli i procedurave të ndjekura për vjeljen e të ardhurave ,politikat fiskale ,zhvillimit ekonomik dhe turizmit etj.	I lartë
4	<u>Drejtoria e Administrimit të Cështjeve Ekonomike dhe Financiare</u> :Kontrolli i buxhetit,kontabiliteti,magazina, si dhe sistemi i detyrimeve të prapambetura dhe kontrolli i detyrimeve të prapambetura .	I lartë	<u>Drejtoria e Administrimit të Cështjeve Ekonomike dhe Financiare</u> :Kontrolli i buxhetit,kontabiliteti,magazina, si dhe sistemi i detyrimeve të prapambetura dhe kontrolli i detyrimeve të prapambetura .	I lartë	<u>Drejtoria e Administrimit të Cështjeve Ekonomike dhe Financiare</u> :Kontrolli i buxhetit,kontabiliteti,magazina, si dhe sistemi i detyrimeve të prapambetura dhe kontrolli i detyrimeve të prapambetura .	I lartë
5	<u>Drejtoria e Kujdesit Social:Menaxhimi i procesit ,plotësia e dosjeve .</u>	I mesëm	<u>Drejtoria e Planifikimit , Kontrollit të Territorit . Mjedisit dhe Pronave</u> : Ndjekja e zbatimit të kontratave të investimeve,procedurat për dhenien e lejeve të ndërtimit etj.	I lartë	<u>Sport Klub Dulgiza SHPK</u> : Sistemi i kontabilitetit,sistemi i pagave,shërblimeve dhe shërbimeve,sistemi i planifimit e realizimit të të ardhurave nga aktivitetete sportive etj.	I lartë

6	<p>Sport Klub Bulqiza SHPK: Sistemi i kontabilitetit, sistemi i pagave, sherblimeve dhe sherbimeve, sistemi i planifimit e realizimit të të ardhurave nga aktivitetete sportive etj.</p>	I lartë	<p>Agjensia e Funksioneve të Transferueshme (Agjensia e Publike): Menaxhimi i shërbimeve dhe inspektimi në terren , mirmbajtja e rrugëve , mjeteve te transportit, menaxhimit te institucioneve arsimore dhe punëve publike, dekorit dhe mirmbajtjes se qytetit , etj .</p>	I lartë	<p>Drejtoria e Planifikimit , Kontrollit të Territorit , Mjedisit dhe Pronave : Ndjekja e zbatimit të kontratave të investimeve, procedurat për dhenien e lejeve të ndërtimit etj .</p>	I lartë
7	<p>Agjensia e Funksioneve të Transferueshme (Agjensia e Shërbimeve Publike) : Menaxhimi i shërbimeve dhe inspektimi në terren , mirmbajtja e rrugëve , mjeteve te transportit, menaxhimit te institucioneve arsimore dhe punëve publike, dekorit dhe mirmbajtjes se qytetit , etj .</p>	I lartë	<p>Sport Klub Bulqiza SHPK: Sistemi i kontabilitetit, sistemi i pagave, sherblimeve dhe sherbimeve, sistemi i planifimit e realizimit të të ardhurave nga aktivitetete sportive etj.</p>	I lartë	<p>Agjensia e Funksioneve të Transferueshme (Agjensia e Shërbimeve Publike) : Menaxhimi i shërbimeve dhe inspektimi në terren , mirmbajtja e rrugëve , mjeteve te transportit, menaxhimit te institucioneve arsimore dhe punëve publike, dekorit dhe mirmbajtjes se qytetit , etj .</p>	I lartë
8	<p>Njësia Administrative Ostren : Menaxhimi i shërbimeve dhe inspektimi ne teren .</p>	I ulët	<p>Drejtoria e Shërbimeve Sociale , Arsimit , Trashëgimisë kulturore , Rinisë dhe Sporteve : Organizimi i aktiviteteteve , sportive e rinore , planifikimi i aktiviteteteve , performanca në realizimin e tyre , etj.</p>	I mesëm	<p>Drejtoria e Funksioneve të Patransferueshme: Procedurat , planet, masat per gjoba , rekrutim i inspektoreve, rekrutimi i rrisqeve . Planet e Inspektimeve, vendosje objektivash , zvogelimi i rriskut nga fatkeqesite dhe mbrojtjen civile , planet e inspektimeve , vendosje objektivash, Planet e masave e marra , zbatimi i tyre, rekrutimi i rrisqeve etj.</p>	I mesëm
9	<p>Drejtoria e Planifikimit , Kontrollit të Territorit , Mjedisit dhe Pronave : Ndjekja e zbatimit të kontratave të investimeve, procedurat për dhenien e lejeve të ndërtimit etj .</p>	I lartë	<p>Njësia Administrative Martanesh : Menaxhimi i shërbimeve dhe inspektimi ne teren .</p>	I ulët	<p>Spektori i Integritimit European dhe Ndhmës së huaj: Vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera nga BE.</p>	I mesëm
10	<p>Auditim sipas kërkesave te titullarit</p>		<p>Auditim sipas kërkesave te titullarit</p>		<p>Auditim sipas kërkesave te titullarit</p>	

	Auditim sipas kerkesave te titullarit		Auditim sipas kerkesave te titullarit		Auditim sipas kerkesave te titullarit	
	10		10		10	

Drejtuksi i NJAB Belina Toska



Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2026

Nr	Subjekte të synuara për tu audituar	Fusha për tu audituar	Auditime Gjithsej (4.1+4.2+4.3+4.4+4.5+4.6)	Shërbimet e Sigurisë					Shërbimet konsulencës	Grupi i Auditimit (nr.auditues)
				A. të përputhshmërisë	A. të performancës	Financiare	A.tek.Informacionit	A. të kombinuara		
a.	1	2	3	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	4.6	5
1	Bashkia Bulqizë									
1.1		Kontrolli i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2025.	1	1						3
1.2	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerzore ,Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse	Kontrolli i procesit të rekrutimit ,regjistri i personelit, rregulloret ,etj dhe sistemi i prokurimeve ,formulimi i kontratave .	1	1						3
1.3	Drejtoria e Administrimit të Cështjeve Ekonomike dhe Financiare	Kontrolli i buxhetit,kontabiliteti,magazina, si dhe sistemi i detyrimeve të prapambetura dhe kontrolli i detyrimeve të prapambetura .	1					1		3
1.4	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmi	Kontrolli i procedurave të ndjekura për vjeljen e të ardhurave ,politikat fiskale ,zhvillimit ekonomik dhe turizmit etj	1	1						3
1.5	Drejtoria e Planifikimit , Kontrollit të Territorit , Mjedisit dhe Pronave	Ndjekja e zbatimit të kontratave të investimeve,procedurat për dhenien e lejeve të ndërtimit etj.	1						1	3
1.6	Agjensia e Funksioneve të Transferueshme(Agjensia e Shërbimeve Publike)	Menaxhimi i shërbimeve dhe inspektimi në terren , mirmbajtja e rrugëve ,mjeteve te transportit,menaxhimit te institucioneve arsimore dhe punëve publike,dekorit dhe mirmbajtjes se qytetit ,etj .	1	1						3

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË BASHKINË BULQIZË

Pasqyra 5

Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2026

Nr	BURIMET E PLANIFIKUARA			Nr	BUXHETI I PLANIFIKUAR	
	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të NJAB	Ditë për tregues	Përlllogaritja e burimeve		Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NJAB	Plani
1	Koha maksimale e vlefshme	780	52jave * 5 dite * 3 punonjes	1	Buxheti Gjithsej	2,584,760
2	Pushime Vjetore	66	22 dite * 3 persona	2	Paga dhe Sig. Shoqërore	2,371,260
3	Dite pushimi (Festa Zyrtare)	27	9 dite * 3 persona	3	Shpenzime Udhëtimi & Dieta	193,500
4	Pushime për arsye shëndetësore	15	5 dite * 3 persona	4	Të tjera	20,000
5	Angazhime në trajnime	15	5dite * 3 persona	5	Numri i Punonjësve	3
6	Angazhime në mbledhje/takime	12	4dite * 3 person	6	Kosto për Person (1/5)	861,587
7	Rezerva të Planifikuara (të papritura)	6	2 dite*3 punonjes			
	TOTALI	639	213 ditë/person			

Drejtuesi i NJAB Belina Toska

